



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:018759
Datë: 05.12.2024
Numri i dokumentit: 06552078

C-III-15-0703

Paditësi; NTP B nga fshati K, Komuna e Ferizajt.

Kundër

Pala e paditur: NSH Plantacioni i Pemëve –Ferizaj e cila administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga Dritan Hoxha nr.55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjyqtarin Asllan Krasniqi në seancën dëgjimore publike të datës 02.12.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M P Ë R S H K A K T Ë M O S P A R A Q I T J E S

Hedhet poshtë kërkesëpadia e paditësit NTP B nga fshati K, Komuna e Ferizajt e parashtruar kundër të paditurës NSH Plantacioni i Pemëve me seli në Ferizaj i cili administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, me të cilën ka kërkuar të vërtetohet që pala e paditur si zotëruese e sendit të rrezikshëm është fajtores për zhdukjen e bletishtës në sasi prej 80 shoqërive; të konstatohet që nga zhdukja e bletishtës paditësit i është shkaktuar dëm në shumën prej 30,760.00 €; dhe të detyrohet pala e paditur që t’ia kompensoj dëmin e konstatuar në shumën prej 30,760.00 €, me normë të kamatës në shkallën prej 3.5 %, duke llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive që të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nuk caktohen taksa gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Paditësi NTP “B ka parashtruar padi kundër të paditurës NSH Plantacioni i Pemëve me seli në Ferizaj i cili administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, për kompensim dëmi. Me padi i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të lëndës kërkesëpadia e tij të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të vërtetohet që pala e paditur si zotëruese e sendit të rrezikshëm është fajtores për zhdukjen e bletishtës në sasi prej 80 shoqërive; të konstatohet se që nga zhdukja e bletishtës paditësit i është shkaktuar dëm në shumën prej 30,760.00 €; dhe të detyrohet pala e paditur që t’ia kompensoj dëmin e konstatuar në shumën prej 30,760.00 €, me normë të kamatës në shkallën prej 3.5 %, duke llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë e deri në

pagesën definitive që të gjitha këto në afatin kohor prej 15 ditëve, llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme e Kosovës ka ftuar me ftesa të rregullta palët ndërgjyqëse për të prezantuar në seancën e datës; 02.12.2024 dhe ka vlerësuar se sipas shënimeve të cilat gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet se të njëjtit i kanë pranuar ftesat me datën 13.11.2024, mirëpo në seancë nuk ka pretenduar pala paditëse dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

I autorizuari i AKP-së në seancën e mbajtur me datën 02.12.2024 pas njoftimit nga gjykata pala paditëse nuk prezanton në këtë seancë edhe pse ftesën e ka pranuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt dhe mosardhjen e tij në këtë seancë nuk e ka arsyetuar, i ka propozuar gjykatës që të merr Aktgjykim për shkak të mosparaqitjes konform nenit 58 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr.06/L-086.

Gjykata ka aprovuar propozimin e palës së paditur bazuar në dispozitën e nenit 58 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.06/L-086 duke vendosur ashtu si është përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës;

Në bazë të nenit 62 paragrafi 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, secila palë do ti heqë shpenzimet e veta.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet kërkesë me shkrim në afatin kohor prej 30 ditëve për prishjen e këtij aktgjykimi Gjykatës së shkallës së parë e cila e ka marrë këtë aktgjykim, ndërsa nëse kjo gjykatë e refuzon kërkesën e palës paditëse me aktvendim, atëherë i njëjti mund ti drejtohet me ankesë Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda afatit prej 15 ditësh, llogaritur nga data e pranimit të këtij aktvendimi.

Gjyqtari,
Asllan Krasniqi